



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.109 dt.28.09.2001

**PER
HAPJEN E SEGMENTIT TE RI TE RR. SAMI FRASHERI**

Mbështetur në nenin 113.2 të Lushtetutës, në ligjin Nr.8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I

1. Të miratohet hapja e vazhdimit të Rrugës Sami Frashëri në segmentin nga Rr. Myslym Shyri deri në daljen në Rr. E Kavajës
2. Hapja e këtij segmenti të bëhet sipas Planit të Përgjithshëm Rregullues të Tiranës
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Urban me bërjen e projektit përkatës që të përfshijë projektin e rrugës së re, pronat që do të përfshihen në shpronësim për interes publik, koston e përafërt të shpronësimeve dhe projektin e zhvillimit të ndërtimeve përgjatë rrugës së re
4. Ngarkohet Bashkia e Tiranës me zbatimin e këtij vendimi
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

Leonidha TOSKA